



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA HIMARË
DREJTORIA JURIDIKE

Nr. 631 prot.

Himarë, më 23.01. 2026

Lënda: Dërgohet për miratim projektvendimi “Për krijimin e shoqërisë bashkiake “HIMARA INVEST” SH.P.K., në pronësi 100 % të Bashkisë Himarë”.

KESHILLIT BASHKIAK HIMARË, ✓

Himarë

Në mbështetje të neneve 8, 9, 54 dhe 55 të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, të ndryshuar; ligjit nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”; dhe Urdhrit të Kryetarit të Bashkisë Himarë nr.709, datë 12/12/2025, “Për ngritjen e grupit të punës për përgatitjen e dokumentacionit të krijimit të shoqërisë bashkiake “Himara Invest” sh.p.k.”, si dhe në relacionin e paraqitur nga grupi i punës, me propozimin e Kryetarit të Bashkisë Himarë;

Bashkëlidhur ju dërgojmë:

- Projektvendimin “Për krijimin e shoqërisë bashkiake “HIMARA INVEST” SH.P.K., në pronësi 100 % të Bashkisë Himarë”.
- Relacion: Mbi projektvendimin “Për krijimin e shoqërisë bashkiake “HIMARA INVEST” SH.P.K., në pronësi 100 % të Bashkisë Himarë”
- Aktin e themelimit (aneksi 1 i projekt vendimit) të shoqërisë “HIMARA INVEST” sh.p.k.
- Statutin (aneksi 2 i projekt vendimit) e shoqërisë “HIMARA INVEST” sh.p.k.
- Memo të Drejtorisë së Financës dhe Planifikimit të Buxhetit me nr.8705prot., datë 02/12/2025 “Për nevojën e krijimit të shoqërisë bashkiake “Himara Invest” sh.p.k.”.

KRYETARI
Vangjel Tavo





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA HIMARË
DREJTORIA JURIDIKE

Nr. 631/11 prot.

Himarë, më 23.01.2026

PROJEKT VENDIM

Nr. 6, datë 23.01.2026
PËR

**“KRIJIMIN E SHOQËRISË BASHKIAKE “HIMARA INVEST” SH.P.K., NË
PRONËSI 100 % TË BASHKISË HIMARË”**

Në mbështetje të neneve 8, 9, 54 dhe 55 të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, të ndryshuar; ligjit nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”; dhe Urdhrit të Kryetarit të Bashkisë Himarë nr.709, datë 12/12/2025, “Për ngritjen e grupit të punës për përgatitjen e dokumentacionit të krijimit të shoqërisë bashkiake “Himara Invest” sh.p.k.”, si dhe në relacionin e paraqitur nga grupi i punës, me propozimin e Kryetarit të Bashkisë Himarë:

V E N D O S I:

1. Të krijohet shoqëria bashkiake me përgjegjësi të kufizuar me emrin “HIMARA INVEST” sh.p.k., me pronësi 100% të Bashkisë Himarë.
2. Shoqëria do të ketë formën juridike “SH.P.K” dhe do të funksionojë në përputhje me ligjin nr. 9901/2008, “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, të ndryshuar.
3. Miratimin e aktit të themelimit (aneksi 1) dhe statutit (aneksi 2) të shoqërisë “HIMARA INVEST” sh.p.k.
4. Pronari i vetëm dhe ortak i vetëm i shoqërisë është Bashkia Himarë, e përfaqësuar nga Kryetari i Bashkisë në cilësinë e Asamblesë së Ortakëve.
5. Shoqëria do të ketë selinë në qytetin e Himarës, Rruga “25 Marsi”, Nr.2, Spile, Himarë, pranë godinës së Bashkisë Himarë.
6. Të ngarkojë Kryetarin e Bashkisë apo personin e autorizuar prej tij, që të nënshkruajë aktet e themelimit të kësaj shoqërie tregtare si dhe për ndjekjen e procedurave për regjistrim në Qendrën Kombëtare të Biznesit.
7. Kapitali fillestar i shoqërisë “Himara Invest” sh.p.k. përcaktohet në vlerën 100 (njëqind) lekë dhe sigurohet nga buxheti i Bashkisë Himarë për vitin 2026. Transferimi i kapitalit fillestar kryhet pas regjistrimit të shoqërisë në Qendrën Kombëtare të Biznesit, në përputhje me procedurat financiare dhe ligjore në fuqi.
8. Ngarkohet Drejtoria e Financës dhe Planifikimit të Buxhetit për ndjekjen e procedurave financiare që lidhen me krijimin dhe funksionimin fillestar të shoqërisë, përfshirë dokumentacionin financiar, mbështetjen buxhetore dhe transferimin e kapitalit fillestar.

9. Bashkia Himarë vë në dispozicion të shoqërisë “Himara Invest” sh.p.k., nga inventari i pasurive në pronësi ose administrim të saj, ambientet dhe asetet e nevojshme për fillimin dhe ushtrimin e veprimtarisë së shoqërisë, sipas akteve përkatëse administrative.
10. Objekti i veprimtarisë së shoqërisë do të përfshijë:
- Menaxhimin e plazheve publike dhe hapësirave bregdetare, përfshirë administrimin, mirëmbajtjen, ofrimin e shërbimeve sezonale, sigurinë dhe zbatimin e standardeve bashkëkohore, në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi;
 - Menaxhimin, zhvillimin dhe shfrytëzimin ekonomik të aseteve bashkiake, përfshirë pronat, ambientet, infrastrukturën publike dhe pasuritë e tjera në pronësi të Bashkisë Himarë, me synim rritjen e të ardhurave dhe përdorimin e qëndrueshëm të tyre;
 - Administrimin e shërbimeve publike me karakter tregtar dhe shërbimeve të tjera që i delegohen shoqërisë nga Bashkia Himarë;
 - Zhvillimin dhe zbatimin e projekteve zhvillimore në fushën e turizmit, bujqësisë, zhvillimit rural, mjedisit dhe kulturës, në përputhje me politikat e zhvillimit lokal dhe nëpërmjet shfrytëzimit të fondeve bashkiake, kombëtare dhe të donatorëve;
 - Realizimin e punimeve të mirëmbajtjes, rikonstruksionit dhe ndërhyrjeve teknike në objektet dhe infrastrukturën publike, në funksion të objektit të veprimtarisë së shoqërisë dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi për prokurimet dhe ndërtimin;
 - Hyrjen në marrëdhënie kontraktuale, marrëveshje, akte bashkëpunimi apo forma të tjera juridike të lejuara nga legjislacioni në fuqi, me palë të treta, publike ose private, vendase ose të huaja, në funksion të ushtrimit të veprimtarisë së shoqërisë, gjenerimit të të ardhurave, si dhe nxitjes së zhvillimit të turizmit, bujqësisë dhe ekonomisë lokale në territorin e Bashkisë Himarë.
 - Ushtrimin e çdo veprimtarie tjetër ndihmëse apo plotësuese të lejuar nga ligji, që lidhet drejtpërdrejt me zhvillimin ekonomik lokal dhe përmirësimin e shërbimeve publike.
11. Shoqëria “Himara Invest” sh.p.k. ka të drejtë të hyjë në marrëdhënie kontraktuale, marrëveshje, akte bashkëpunimi apo forma të tjera juridike të lejuara nga ligji, me palë të treta vendase ose të huaja, në funksion të ushtrimit të veprimtarisë së saj, gjenerimit të të ardhurave dhe nxitjes së zhvillimit të turizmit, bujqësisë dhe ekonomisë lokale.
12. Organet drejtuese të shoqërisë janë:
- Asambleja e Ortakëve, e përfaqësuar nga Kryetari i Bashkisë Himarë;
 - Administratori i shoqërisë, i cili emërohet nga Asambleja e Ortakëve, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet themeluese të shoqërisë.
13. Administratori është përgjegjës për drejtimin dhe administrimin e veprimtarisë së shoqërisë, për zbatimin e statutit, aktit të themelimit dhe vendimeve të Asamblesë së Ortakëve, si dhe për raportimin periodik të gjendjes financiare dhe operacionale të shoqërisë pranë Bashkisë Himarë.
14. Shoqëria “Himara Invest” sh.p.k. mban regjistrim të plotë kontabël dhe pasqyra financiare, në përputhje me standardet kombëtare të kontabilitetit dhe legjislacionin në fuqi.
15. Fitimi vjetor i shoqërisë, pasi të jenë shlyer në kohë të gjitha detyrimet tatimore, financiare dhe kontraktuale, përfshirë detyrimet ndaj furnitorëve, punonjësve dhe palëve të treta, i transferohet Bashkisë Himarë, në masën dhe mënyrën që përcaktohet me vendim të Asamblesë së Ortakëve, duke marrë parasysh nevojat për arritjen e

objektivave, synimeve, fushës së veprimtarisë, si dhe nevojat për funksionimin dhe zhvillimin e shoqërisë.

16. Shoqëria harton çdo vit planin vjetor të veprimtarisë dhe pasqyrat financiare, të cilat miratohen nga Asambleja e Ortakëve dhe i paraqiten Këshillit Bashkiak Himarë për informim.
17. Bashkia Himarë, nëpërmjet strukturave të saj përkatëse, ndjek dhe monitoron aspektet financiare dhe administrative të veprimtarisë së shoqërisë, në përputhje me legjislacionin në fuqi.
18. Shoqëria mund të krijojë zyra apo filiale, brenda dhe jashtë territorit të Bashkisë Himarë, kudo ku kjo vlerësohet e nevojshme për zhvillimin e veprimtarisë dhe arritjen e objektivave dhe synimeve të saj, me miratim të Asamblesë së Ortakëve.
19. Ngarkohet Administratori i shoqërisë, pas emërimit, të ndërmarrë të gjitha procedurat e nevojshme për pajisjen me NIPT, regjistrimet përkatëse fiskale, hapjen e llogarive bankare, organizimin e strukturës administrative dhe funksionale të shoqërisë, si dhe lidhjen e marrëdhënieve kontraktuale të domosdoshme për fillimin e veprimtarisë.
20. Çdo vendim i mëparshëm që bie ndesh me funksionet e këtij vendimi shfuqizohet.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas miratimit dhe ngarkohet për zbatimin e tij Kryetari i Bashkisë Himarë, Drejtoria e Financës dhe Planifikimit të Buxhetit, Drejtoria e Menaxhimit të Aseteve dhe Drejtoria Juridike, si dhe Administratori i shoqërisë "Himara Invest" sh.p.k., pas emërimit.

KRYETARI

Vangjel Tavo





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA HIMARË
DREJTORIA JURIDIKE

Nr. 631/2 prot.

Himarë, më 23.01 . 2026

RELACION:

**MBI PROJEKT VENDIMIN “PËR KRIJIMIN E SHOQËRISË BASHKIAKE
“HIMARA INVEST” SH.P.K., NË PRONËSI 100 % TË BASHKISË HIMARË”**

Të nderuar Këshilltarë!

Projekt vendimi që po ju paraqesim vjen pasi është marrjes në shqyrtim të memos të Drejtorisë së Financës dhe Planifikimit të Buxhetit me nr.8705prot., date 02/12/2025 për nevojën e krijimit të shoqërisë bashkiake “Himara Invest” sh.p.k., urdhrit të nxjerrë nga Kryetari i Bashkisë Himarë nr. 709, datë 12/12/2025, “Për ngritjen e grupit të punës për përgatitjen e dokumentacionit të krijimit të shoqërisë bashkiake “Himara Invest” sh.p.k. grupi i punës në zbatim të pikës 2 të këtij urdhri ka përgatitur të gjithë materialin e nevojshme për krijimin e një shoqërie tregtare bashkiake me përgjegjësi të kufizuar, me emrin **“HIMARA INVEST” SH.P.K.**, në pronësi 100% të Bashkisë Himarë, si instrument për menaxhimin më efikas, transparent dhe profesional të aseteve bashkiake dhe të shërbimeve publike me interes ekonomik lokal.

I. BAZA LIGJORE

Ky relacion paraqitet për shqyrtim dhe miratim nga Këshilli Bashkiak, në mbështetje të:

- Ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, veçanërisht nenet 8, 9, 54 dhe 55, që parashikojnë të drejtën e njësive të vetëqeverisjes vendore për të krijuar shoqëri tregtare në funksion të ushtrimit të kompetencave të tyre;
- Ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, të ndryshuar;
- Ligjit nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”;
- Memos të Drejtorisë së Financës dhe Planifikimit të Buxhetit me nr.8705prot., date 02/12/2025 për nevojën e krijimit të shoqërisë bashkiake “Himara Invest” sh.p.k.
- Urdhrit të Kryetarit të Bashkisë Himarë nr. 709, datë 12.12.2025, për ngritjen e grupit të punës për përgatitjen e dokumentacionit për krijimin e shoqërisë bashkiake.

II. QËLLIMI I PROJEKT VENDIMIT

Ky projekt vendim synon krijimin e kësaj shoqërie e cila synon:

- rritjen e të ardhurave vendore;
- përmirësimin e cilësisë së shërbimeve publike;
- zhvillimin ekonomik lokal të territorit të Bashkisë Himarë;
- administrimin e qëndrueshëm të pasurive publike, veçanërisht atyre bregdetare.

III. ARSYETIMI I KRIJIMIT TË SHOQËRISË

Bashkia Himarë administron një territor me potencial të lartë turistik dhe ekonomik, veçanërisht në zonat bregdetare. Aktualisht menaxhimi i plazheve publike, aseteve bashkiake dhe objekteve publike kërkon një strukturë më fleksibël, profesionale dhe të specializuar, e cila mund të operojë sipas rregullave të tregut, por gjithmonë në interes publik.

Shoqëria “HIMARA INVEST” sh.p.k. do të shërbejë si një mjet operacional për:

- menaxhimin e plazheve publike dhe hapësirave bregdetare;
- shfrytëzimin racional të aseteve bashkiake;
- organizimin dhe administrimin e parkimeve publike me pagesë;
- realizimin e punimeve të ndërtimit, mirëmbajtjes, rikonstruksionit dhe rindërtimit të objekteve publike;
- zhvillimin e veprimtarive ndihmëse që kontribuojnë në zhvillimin ekonomik lokal.

IV. ASPEKTET ORGANIZATIVE DHE FINANCIARE

Shoqëria do të ketë formën juridike **SH.P.K.**, me Bashkinë Himarë si ortak të vetëm, të përfaqësuar nga Kryetari i Bashkisë në cilësinë e Asamblesë së Ortakëve.

Kapitali fillestar do të përcaktohet me anë të urdhrit të Kryetarit të Bashkisë Himarë në zbatim të VKB-së nr.64, datë 22.12.2025 “Për miratimin e buxhetit të bashkisë për vitin 2026”.

Administrimi i shoqërisë do të realizohet nga një Administrator i emëruar nga Kryetari i Bashkisë, i cili do të jetë përgjegjës për:

- zbatimin e statutit dhe aktit të themelimit;
- administrimin financiar dhe operacional;
- raportimin periodik pranë Asamblesë së Ortakëve dhe Këshillit Bashkiak.

Fitimi i realizuar nga shoqëria, pas shlyerjes së detyrimeve ligjore, do t’i transferohet Bashkisë Himarë në masën e përcaktuar nga Këshilli Bashkiak.

V. EFEKTET E PRITSHME

1. Rritja e të ardhurave vendore dhe formalizimi i ekonomisë lokale

Krijimi i shoqërisë “HIMARA INVEST” sh.p.k. pritet të ndikojë drejtpërdrejt në rritjen e të ardhurave vendore përmes menaxhimit të strukturuar dhe të kontrolluar të plazheve publike dhe aseteve të tjera bashkiake. Këto aktivitete, të cilat aktualisht zhvillohen në mënyrë të fragmentuar ose me efikasitet të kufizuar, do të formalizohen dhe do të administrohen sipas rregullave të tregut, duke garantuar të ardhura të qëndrueshme për buxhetin e Bashkisë.

Formalizimi i këtyre veprimtarive ndikon gjithashtu në uljen e informalitetit, veçanërisht gjatë sezonit turistik, ku fluksi ekonomik është më i lartë.

2. Zhvillimi i qëndrueshëm i turizmit dhe përmirësimi i shërbimeve turistike

Turizmi përbën sektorin kryesor ekonomik të zonës së Himarës. Menaxhimi i plazheve publike dhe hapësirave bregdetare nga një shoqëri e specializuar bashkiake do të mundësojë ofrimin e shërbimeve cilësore, të standardizuara dhe në përputhje me kërkesat e turistëve vendas dhe të huaj. Kjo do të ndikojë pozitivisht në imazhin turistik të zonës, në zgjatjen e sezonit turistik dhe në rritjen e konsumit lokal, duke përfutur drejtpërdrejt bizneset e vogla, strukturat akomoduese, restorantet dhe shërbimet mbështetëse.

3. Mbështetje direkte dhe indirekte për bujqësinë, blegtorinë dhe bletarinë lokale

Zhvillimi i turizmit dhe rritja e numrit të vizitorëve krijon kërkesë të shtuar për produkte bujqësore, blegtorale dhe bletarie vendase, si vaj ulliri, fruta, perime, produkte të bulmetit dhe mjaltë. Përmes menaxhimit më efikas të aseteve bashkiake dhe krijimit të hapësirave funksionale (tregje, pika shitjeje, ambiente shërbimi), shoqëria bashkiake mund të krijojë kushte më të favorshme për promovimin dhe tregtimin e produkteve lokale, duke forcuar zinxhirin ekonomik mes turizmit dhe prodhimit vendas.

4. Përmirësimi i infrastrukturës publike dhe aseteve bashkiake

Shoqëria "HIMARA INVEST" sh.p.k. do të angazhohet në realizimin e punimeve të mirëmbajtjes, rikonstruksionit dhe ndërtimit të objekteve publike, çka do të ndikojë drejtpërdrejt në përmirësimin e infrastrukturës urbane dhe rurale. Infrastruktura funksionale dhe e mirëmbajtur është thelbësore jo vetëm për turizmin, por edhe për bujqësinë dhe aktivitetet prodhuese, pasi lehtëson aksesin, transportin e produkteve dhe shërbimet bazë për komunitetin lokal.

5. Krijimi i vendeve të reja të punës dhe rritja e punësimit sezonal dhe të qëndrueshëm

Funksionimi i shoqërisë do të sjellë krijimin e vendeve të reja të punës, si në administrimin e shoqërisë ashtu edhe në zbatimin e projekteve konkrete në terren. Kjo është veçanërisht e rëndësishme për zonën e Himarës, ku një pjesë e konsiderueshme e popullsisë mbështetet në punësimin sezonal. Përmes kësaj shoqërie krijohen mundësi për punësim më të strukturuar dhe më të qëndrueshëm, duke ndikuar pozitivisht në mirëqenien ekonomike të banorëve vendas.

6. Menaxhim më transparent dhe kontroll më i mirë financiar

Shoqëria do të funksionojë mbi baza të qarta ligjore, me regjistrim të plotë kontabël dhe raportim periodik financiar pranë organeve të Bashkisë. Kjo garanton transparencë në përdorimin e aseteve publike dhe të ardhurave të gjeneruara, si dhe rrit besimin e komunitetit dhe aktorëve ekonomikë lokalë në menaxhimin e pasurive të përbashkëta.

VI. PËRFUNDIME DHE PROPOZIM

Në përfundim, krijimi i shoqërisë bashkiake "HIMARA INVEST" sh.p.k. përbën një hap të rëndësishëm drejt modernizimit të menaxhimit të shërbimeve dhe aseteve bashkiake, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe interesin publik të Bashkisë Himarë.

Në përfundim, miratimi i këtij projektvendimi konsiderohet i domosdoshëm dhe i justifikuar, pasi garanton përdorim më efektiv të pasurisë publike, respektim të kuadrit ligjor dhe nxit zhvillimin institucional e ekonomik. Për këto arsye, propozohet miratimi i projektvendimit për krijimin e shoqërisë bashkiake "HIMARA INVEST" SH.P.K., në pronësi 100 % të Bashkisë Himarë.

Për të gjitha arsyet e mësipërme, vlerësojmë se miratimi i kësaj shoqërie është i domosdoshëm, pasi ajo shërben si përgjigje ndaj nevojave reale për instrumente për menaxhimin më efikas, transparent dhe profesional të aseteve bashkiake dhe të shërbimeve publike me interes ekonomik lokal, detyrimeve ligjore, si edhe ngarkesës së shtuar të punës që vjen jo vetëm nga zgjerimi i funksioneve bashkiake, por edhe nga specifikat territoriale dhe sezonaliteti i lartë turistik.

Në këto kushte, kërkojmë miratimin e këtij projektvendimi nga Këshilli i Bashkisë Himarë, duke theksuar gjithashtu gatishmërinë për të reflektuar çdo propozim për ndryshim apo plotësim të kësaj strukture nga ju, të nderuar këshilltarë

GRUPI I PUNËS PËR PËRGATITJEN E DOKUMENTACIONIT TË KRIJIMIT TË SHOQËRISË BASHKIAKE "HIMARA INVEST" SH.P.K.

KRYETAR

Besa Xhaferi



ANËTAR

Rajmonda Zisi




ANËTAR

Ardit Muhametaj



AKT THEMELIMI

**I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
ME SELI NË HIMARË "HIMARA INVEST" SH.P.K.**



Sot, më datë ____/____/2026 (dymijë e njëzet e gjashtë), Ortaku themelues:

VENDOSI

BASHKIA HIMARË, me adresë: Rruga "25 Marsi", Nr.2, Spile, Himarë, dhe me NIPT: K56703211V, përfaqësuar nga Kryetari i Bashkisë Vangjel TAVO, themelimin e shoqërisë "HIMARA INVEST" Sh.p.k., përmes këtij akt-themelimi.

NENI 1

1. Shoqëria Tregtare **HIMARA INVEST Sh.p.k.**, themelohet në formën e një Shoqërie me përgjegjësi të kufizuar, në përputhje me ligjin 9901, datë 14/04/2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", të ndryshuar (këtu e më poshtë Shoqëria).
2. Shoqëria është një entitet ligjor shqiptar dhe ka formën ligjore të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar ("shoqëri me përgjegjësi të kufizuar" ose "sh.p.k."). Ortakët e shoqërisë ("Ortakët") gëzojnë përgjegjësi të kufizuar deri në limitin e kontributit përkatës në kapitalin e shoqërisë.
3. Ortakët mund të kryejnë në bazë të një vendimi të Asamblesë së Ortakëve, financime për llogari të shoqërisë në përpjesëtim me pjesëmarrjen e zotëruar në kapital, mbulimin e humbjeve ashtu edhe për financime jo fitimprurëse.

NENI 2

Emri dhe vula e shoqërisë

Shoqëria, do të dalë në qarkullimin juridiko-civil me emrin **HIMARA INVEST Sh.p.k.**
Shoqëria do të ketë vulën e saj.

NENI 3

Objekti i veprimtarisë

1. Shoqëria ka për objekt veprimtarie:
 - Në funksion të realizimit të objektivave të saj zhvillimore dhe në përputhje me politikat e zhvillimit lokal të bashkisë, Shoqëria ushtron veprimtari që synojnë rritjen e eficiencës në menaxhimin e pasurive dhe shërbimeve bashkiake me potencial ekonomik, krijimin e të ardhurave vetjake për bashkinë dhe forcimin e autonomisë financiare lokale, si dhe përmirësimin e cilësisë së shërbimeve publike për qytetarët dhe turistët, veçanërisht gjatë

sezonit turistik. Në këtë kuadër, Shoqëria ushtron veprimtari që lidhen me menaxhimin profesional dhe ekonomik të aseteve publike përmes një strukture të specializuar që operon sipas parimeve të tregut, optimizimin e modelit të administrimit të pasurive bashkiake me synim gjenerimin e të ardhurave afatgjata dhe të qëndrueshme, reduktimin e kostove operative dhe rritjen e kapaciteteve investuese të bashkisë.

- Shoqëria zhvillon dhe administron veprimtari në fushën e menaxhimit të plazheve publike dhe hapësirave bregdetare, administrimit të shërbimeve publike me karakter tregtar, zhvillimit dhe zbatimit të projekteve turistike dhe promovimit të destinacionit, si dhe menaxhimit të eventeve publike me synim zgjatjen e sezonit turistik dhe rritjen e vlerës ekonomike të territorit.
- Gjithashtu, Shoqëria nxit dhe koordinon projekte zhvillimore në sektorin bujqësor dhe blegtoral, përfshirë bashkëpunimin me fermerët dhe blegtorët e zonës, mbështetjen e prodhimit vendor, rritjen e cilësisë dhe qëndrueshmërisë ekonomike, si dhe integrimin e prodhimeve lokale në zinxhirët e vlerës turistike dhe tregtare të bashkisë, në bashkëpunim me të gjithë aktorët publik dhe privat, kooperativat bujqësore, shoqatat e fermerëve dhe subjektet agro-përpunuese.
- Për realizimin e objektit të saj, Shoqëria identifikon, harton, zbaton dhe menaxhon projekte zhvillimore shumë-sektoriale në fushën e turizmit, bujqësisë, zhvillimit rural, mjedisit dhe kulturës, duke shfrytëzuar fondet bashkiake, fondet kombëtare, fondet e donatorëve, programet e Bashkimit Evropian, si dhe forma të tjera financimi, bashkëfinancimi dhe bashkëpunimi strategjik, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe interesin publik.
- Projektim, ndërtim, rindërtim, zbatim, kolaudim të ndërtimeve të të gjitha llojeve, duke përfshirë këtu, por pa u kufizuar në ndërtime me qëllim banimi, rindërtimin, ndërtime me karakter social, kulturor, industrial, publik kur është rasti, si dhe ndërtime të tjera me karakter tregtar.
- Kryerja e investimeve duke mobilizuar kapital shtetëror dhe/ose privat vendas apo të huaj. Realizimin e punimeve të ndërtimit, mirëmbajtjes, rikonstruksionit, rindërtimit dhe sigurimit të ndërtesave dhe objekteve publike ekzistuese dhe të reja, kur është rasti. Ndërtimin, instalimin dhe mirëmbajtjen e veprave, fasadave, ndërtesave publike dhe private si dhe menaxhimin e shërbimeve, mallrave dhe punimeve publike për realizimin e tyre.
- Kryerjen e punimeve për restaurimin e ndërtesave artistike, kulturore e publike në administrim publik. Kerkime, studime, planifikim, projektim dhe drejtim te punimeve ne sektorin e ndertimit dhe inxhinierise ne pergjithesi, perfshire te gjitha disiplinat dhe instrumentet qe kane lidhje me keto fusha. Keshillimi dhe planifikimi ne sektorin e sherbimeve publike dhe/ose private.
- Realizimin, krijimin, zhvillimin, menaxhimin dhe shitjen e projekteve, pasurive, mallrave dhe sherbimeve per arritjen e qellimeve dhe objektiveve tregtare ne perputhje me kete statut dhe me aktet ligjore ne fuqi. Blerje, shite, administrim, te materialeve dhe te cdo lloj pasurie te luajtshme dhe/ose te paluajtshme, ne zbatim e ne perputhje me aktivitetin e shoqerise. Për qëllimin e realizimit të objektit të saj Shoqëria mund:
- Te kryeje çdo aktivitet te ligjshem qe lidhet me pasuri te luajtshme dhe/ose te paluajtshme si dhe te ushtroje te gjitha te drejtat reale te pronarit mbi to duke perfshire por pa u kufizuar

ne zhvillimin, dhenien me qira, enfiteoze, leasing, perdorimin, transferimin, shitjen, perdorimin si hipoteke, peng, garanci ose te perdorimit ne forma te tjera te parashikuara nga legjislacioni ne fuqi, duke u bazuar ne parimet e ruajtjes dhe garantimit te interesit publik, rritjes se vleres ekonomike te prones, kthimin e arsyeshem te investimit, vleren me te mire te parase (fitimet maksimale te mundshme) si dhe leverdisshmerise publike.

- Ne funksion te ushtrimit te veprimtarise se saj, Shoqeria me iniciative te saj dhe ose me propozim te institucioneve, enteve publike, personave fizike apo juridike private, vendas apo te huaj, identifikon zona dhe/ose pasuri te paluajtshme me qellim zhvillimi. Shoqeria mund te zhvilloje keto pasuri si investitore dhe/ose zhvilluese, vete ose ne bashkepunim me sektorin publik dhe/ose privat sipas parashikimeve te legjislacionit ne fuqi. Shoqeria sipas rastit, vendos te jete si investuese dhe/ose zhvilluese e vetme ne projekt investimi ose bashkezhvilluese dhe/ose bashkeinvestuese ne bashkepunim me sektorin public dhe/ose privat, porositese e investimit, apo bashkepjesemarrese ne investim ne çdo lloj forme tjetër te parashikuara nga legjislacioni ne fuqi.
- Me iniciative te vet dhe/apo propozim te subjektit/eve private Shoqeria mund te vendose troje ne pronesi te saj ne dispozicion te zhvilluesit privat me qellim zhvillimin e tyre. Forma e financimit te investimit te ndertimit si dhe forma e bashkepunimit percaktohet rast pas rasti. Kushtet, kriteret dhe procedura e perzgjedhjes te zhvilluesit privat behet ne baze te parimit te konkurrueshmerise dhe te legjislacionit perkates qe rregullon kete fushe pervec rasteve kur sipas analizes ligjore dhe/ose studimit te fizibilitetit eshte e pamundur qe projekti te kete leverdisshmeri nese nuk pershtatet me rrethanat e situatave konkrete, qe diktojne kontraktimin direkt te nje zhvilluesi.
- Ndermjet zhvilluesit dhe shoqerise nenshkruset marreveshja perkatese ku percaktohen te drejtat dhe detyrimet e paleve. Pasurite e perfituara nga zhvillimi/investimi regjistrohen ne emer te shoqerise dhe ajo gezon te gjitha tagrat e pronarit sipas legjislacionit ne fuqi. Shoqeria, me qellimin e vetem per te realizuar objektin e saj, mund te kryeje te gjitha operacionet ne fushen e ndertimit, industrise, tregtise, pasurive te patundshme dhe ne fushen financiare qe lidhen me objektin e shoqerise, ose qe kane lidhje me te, mund gjithashtu te kontribuojë, drejtpersdrejti ose terthorazi, por gjithmone me qellimin e vetem per arrijten e objektit te shoqerise me pjesemarrje dhe interesa ne shoqeri te tjera dhe shoqeri me objekt te njejte ose te ngjashem me te. Te shqyrtoje dhe te vleresoje mundesine e bashkepunimit me shoqeri te tjera tregtare ne te gjitha format qe parashikon legjislacioni ne fuqi.

NENI 4

Selia e Shoqërisë

Selia e Shoqërisë ndodhet në me adresë: Rruga “25 Marsi”, Nr.2, Spile, Himarë, Shqiperi.

NENI 5

Kapitali i Shoqërisë

Kapitali themeltar i shoqërisë përbëhet nga kontributi në para i Ortakut themelues të Shoqërisë. Kontributi në para do të ketë një vlerë nominale të përgjithshme prej 100 (njëqind) lekë, i ndarë në një (1) kuotë e zotëruar nga Ortaku i vetëm.

Ortaku themelues i Shoqërisë tregtare "HIMARAINVEST" Sh.p.k. zotëron kuotën në shoqëri si më poshtë:

Bashkia Himarë, në cilësinë e Ortakut themelues zotëron 100% të vlerës së kapitalit themeltar të barabartë me një kuotë me vlerë të përgjithshme prej 100 (njëqind) lekë.

Kapitali themeltar është derdhur në total nga Ortaku themelues. Vlerësimi dhe pagesa e kapitalit themeltar është kryer nga ortaku me miratimin e këtij Akti.

NENI 6

Kohëzgjatja e shoqërisë

Afati kohor i zhvillimit të aktivitetit të shoqërisë është i papërcaktuar (pa afat) dhe mund të ndryshohet një ose disa herë me vendim të Asamblesë së Ortakëve.

NENI 7

Organet Drejtuese

Duke ju referuar ligjit nr. 9901, datë 14/04/2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", të ndryshuar organet drejtuese të shoqërisë janë si më poshtë vijon:

1. Asamblea e Përgjithshme e Ortakut të Vetëm/ Ortakëve - organi më i lartë vendimmarrës;
2. Administratori/ët - organi ekzekutiv dhe administrativ i shoqërisë.

Organizimi dhe funksionimi i këtyre organeve është përcaktuar në statutin e shoqërisë. Shoqëria administrohet nga Administratori i cili zgjidhet për një mandat pesëvjeçar me të drejtë rizgjedhjeje.

Administrator i Shoqërisë do të jetë:

Z.Donjaldo Hoxha, shtetas shqiptar, lindur në Përmet, më 30/04/1991, madhor e me zotësi të plotë juridike për të vepruar, mbajtës i Kartës së Identitetit me Nr. J11230024H.

Shoqëria përfaqësohet para çdo organi administrativ, gjyqësor, enti publik apo privat dhe në marrëdhënie me të tretët nga administratori, i cili i ushtron këto të drejta në përputhje me Statutin e shoqërisë dhe legjislacionin në fuqi.

NENI 8

Eksperti Kontabël i Autorizuar i shoqërisë do të emërohet në përputhje me legjislacionin përkatës në fuqi dhe për çdo vit financiar shoqëria do të emërojë një ekspert kontabël për të kontrolluar aktivitetin ekonomik të shoqërisë.

NENI 9

Ortakët themelues mund të vendosin me vullnetin e tyre, për pjesëmarrjen në Shoqëri të tjera dhe të krijojnë çdo lloj aktiviteti tjetër privat, me përjashtim të kufizimeve të përcaktuara me ligj.

NENI 10

Organizimi dhe funksionimi, i shoqërisë, ngritja e degëve apo filialeve të saj, do të bëhet në përputhje me dispozitat e ligjit përkatës dhe statutit. Shoqëria ushtron veprimtarinë e saj duke respektuar parimin e interesit publik, transparencës dhe përdorimit të qëndrueshëm të pasurive publike.

NENI 11

Legjislacioni i aplikuar

Aktiviteti i shoqërisë do të rregullohet nga Statuti i firmosur nga Ortaku i Vetem/ Ortakët themelues. Cdo gjë që nuk është parashikuar në Statut do të disiplinohet nga legjislacioni tregtar dhe nga dispozita ligjore në fuqi.

NENI 12

Zgjidhja e Mosmarrëveshjeve

Mosmarrëveshjet që mund të lindin gjatë aktivitetit të shoqërisë zgjidhen me konsensus, në të kundërt palet i drejtohen gjykatës kompetente.

NENI 13

Dispozita Përfundimtare

Akti i themelimit përpilohet në tre kopje të njëjta në gjuhën shqipe.


ORTAKU I VETËM

BASHKIA HIMARË

KRYETARI

Vangjel Tavo





STATUTI

I

SHOQËRISË TREGTARE

“HIMARA INVEST”

SH.P.K.

ME SELI NË HIMARË

Sot, më datë _____.____.2026 (dymijë e njezet e gjashtë), Ortaku themelues:

- **BASHKIA HIMARË**, me adresë: Rruga “25 Marsi”, Nr.2, Spile, Himarë, dhe me NIPT: K56703211V, përfaqësuar nga Kryetari i Bashkisë Vangjel TAVO, përmes këtij akti;

Vendosi themelimin e shoqërisë “HIMARA INVEST” Sh.p.k., me termat si më poshtë:

KAPITULLI I

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

NENI 1

Forma ligjore

Shoqëria është një entitet ligjor shqiptar dhe ka formën ligjore të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar (“shoqëri me përgjegjësi të kufizuar” ose “sh.p.k”).

Ortakët e shoqërisë (“Ortakët”) gëzojnë përgjegjësi të kufizuar deri në limitin e kontributit përkatës në kapitalin e shoqërisë.

Ortakët mund të kryejnë në bazë të një vendimi të Asamblesë së Ortakëve, financime për llogari të shoqërisë në përpjesëtim me pjesëmarrjen e zotëruar në kapital, mbulimin e humbjeve ashtu edhe për financime jo fitimprurëse.

Shoqëria Tregtare “HIMARA INVEST” sh.p.k., rregullon pozitën e saj juridike, marrëdhëniet e themeluesve, të organeve të saj, llojin e Shoqërisë, kohëzgjatjen e veprimtarisë së saj, marrëdhëniet me të punësuarit, duke u bazuar në ligjin nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, (të ndryshuar) dhe dispozitat e tjera të legjislacionit shqiptar në fuqi që rregullojnë marrëdhëniet e Shoqërive Tregtare.

NENI 2

Regjimi juridik i Shoqërsë

Shoqëria udhëhiqet nga parimet e ekonomisë së tregut. Ajo respekton parimin e reciprocitetit. Ajo është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar (sh.p.k.). Veprimtaria e saj i

nënshtrohet dispozitave të Aktit së Themelimit, Statutit si dhe dispozitave të legjislacionit tregtar e atij civil në fuqi.

Me vendim të Asamblesë së Përgjithshme, Shoqëria mundet që të ndryshojë regjimin juridik të saj në përputhje me dispozitat ligjore që do të jenë në fuqi si dhe në përputhje të plotë me dispozitat e Aktit të Themelimit dhe të Statutit të saj. Statuti mund të ndryshojë duke ndjekur normat e mësipërme. Shoqëria gëzon personalitet juridik nga data e regjistrimit të saj në Regjistrin Tregtar. Shoqëria do të ketë vulën e saj.

NENI 3

Emri dhe selia e Shoqërisë

Shoqëria është Person Juridik Privat. Shoqëria do të paraqitet në qarkullimin juridiko-civil emërtimin e saj **“HIMARA INVEST” SH.P.K.**

Selia e Shoqërisë ndodhet në adresën: Rruga “25 Marsi”, Nr.2, Spile, Himarë.

NENI 4

Kohëzgjatja e Shoqërisë

Afati kohor i zhvillimit të aktivitetit është i pacaktuar (pa afat) dhe mund të ndryshohet një ose disa herë me vendim të Asamblesë së Ortakëve.

KAPITULLI II

OBJEKTI

NENI 5

Objekti i veprimtarisë

Shoqëria ka për objekt veprimtarie:

- Në funksion të realizimit të objektivave të saj zhvillimore dhe në përputhje me politikat e zhvillimit lokal të bashkisë, Shoqëria ushtron veprimtari që synojnë rritjen e eficiencës në menaxhimin e pasurive dhe shërbimeve bashkiake me potencial ekonomik, krijimin e të ardhurave vetjake për bashkinë dhe forcimin e autonomisë financiare lokale, si dhe përmirësimin e cilësisë së shërbimeve publike për qytetarët dhe turistët, veçanërisht gjatë sezonit turistik. Në këtë kuadër, Shoqëria ushtron veprimtari që lidhen me menaxhimin profesional dhe ekonomik të aseteve publike përmes një strukture të specializuar që operon sipas parimeve të tregut, optimizimin e modelit të administrimit të pasurive bashkiake me synim gjenerimin e të ardhurave afatgjata dhe të qëndrueshme, reduktimin e kostove operative dhe rritjen e kapaciteteve investuese të bashkisë.
- Shoqëria zhvillon dhe administron veprimtari në fushën e menaxhimit të plazheve publike dhe hapësirave bregdetare, administrimit të shërbimeve publike me karakter tregtar, zhvillimit dhe zbatimit të projekteve turistike dhe promovimit të destinacionit, si dhe menaxhimit të eventeve publike me synim zgjatjen e sezonit turistik dhe rritjen e vlerës ekonomike të territorit.

- Gjithashtu, Shoqëria nxit dhe koordinon projekte zhvillimore në sektorin bujqësor dhe blegtoral, përfshirë bashkëpunimin me fermerët dhe blegtorët e zonës, mbështetjen e prodhimit vendor, rritjen e cilësisë dhe qëndrueshmërisë ekonomike, si dhe integrimin e prodhimeve lokale në zinxhirët e vlerës turistike dhe tregtare të bashkisë, në bashkëpunim me të gjithë aktorët publik dhe privat, kooperativat bujqësore, shoqatat e fermerëve dhe subjektet agro-përpunuese.
- Për realizimin e objektit të saj, Shoqëria identifikon, harton, zbaton dhe menaxhon projekte zhvillimore shumë-sektoriale në fushën e turizmit, bujqësisë, zhvillimit rural, mjedisit dhe kulturës, duke shfrytëzuar fondet bashkiake, fondet kombëtare, fondet e donatorëve, programet e Bashkimit Evropian, si dhe forma të tjera financimi, bashkëfinancimi dhe bashkëpunimi strategjik, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe interesin publik.
- Projektim, ndërtim, rindërtim, zbatim, kolaudim të ndërtimeve të të gjitha llojeve, duke përfshirë këtu, por pa u kufizuar në ndërtime me qëllim banimi, rindërtimin, ndërtime me karakter social, kulturor, industrial, publik kur është rasti, si dhe ndërtime të tjera me karakter tregtar.
- Kryerja e investimeve duke mobilizuar kapital shtetëror dhe/ose privat vendas apo të huaj. Realizimin e punimeve të ndërtimit, mirëmbajtjes, rikonstruksionit, rindërtimit dhe sigurimit të ndërtesave dhe objekteve publike ekzistuese dhe të reja, kur është rasti. Ndërtimin, instalimin dhe mirëmbajtjen e veprave, fasadave, ndërtesave publike dhe private si dhe menaxhimin e shërbimeve, mallrave dhe punimeve publike për realizimin e tyre.
- Kryerjen e punimeve për restaurimin e ndërtesave artistike, kulturore e publike në administrim publik. Kerkime, studime, planifikim, projektim dhe drejtim të punimeve në sektorin e ndërtimit dhe inxhinierisë në përgjithësi, përfshirë të gjitha disiplinat dhe instrumentet që kanë lidhje me këto fusha. Keshillimi dhe planifikimi në sektorin e shërbimeve publike dhe/ose private.
- Realizimin, krijimin, zhvillimin, menaxhimin dhe shitjen e projekteve, pasurive, mallrave dhe shërbimeve për arritjen e qëllimeve dhe objektivave tregtare në përputhje me këtë statut dhe me aktet ligjore në fuqi. Blerje, shitje, administrim, të materialeve dhe të çdo lloji pasurie të luajtshme dhe/ose të paluajtshme, në zbatim e në përputhje me aktivitetin e shoqërisë. Për qëllimin e realizimit të objektit të saj Shoqëria mund:
- Të kryejë çdo aktivitet të ligjshëm që lidhet me pasuri të luajtshme dhe/ose të paluajtshme si dhe të ushtroje të gjithë të drejtat reale të pronarit mbi to duke përfshirë por pa u kufizuar në zhvillimin, dhenien me qira, enfiteoze, leasing, përdorimin, transferimin, shitjen, përdorimin si hipotekë, peng, garanci ose të përdorimit në forma të tjera të parashikuara nga legjislacioni në fuqi, duke u bazuar në parimet e ruajtjes dhe garantimit të interesit publik, rritjes së vlerës ekonomike të pronës, kthimin e arsyeshëm të investimit, vlerën me të mirë të parase (fitimet maksimale të mundshme) si dhe leverdisshmëri publike.
- Në funksion të ushtrimit të veprimtarisë së saj, Shoqëria me iniciative të saj dhe ose me propozim të institucioneve, enteve publike, personave fizike apo juridike private, vendas apo të huaj, identifikon zona dhe/ose pasuri të paluajtshme me qëllim zhvillimi. Shoqëria mund të zhvillojë këto pasuri si investitore dhe/ose zhvilluese, vete ose në bashkëpunim me sektorin publik dhe/ose privat sipas parashikimeve të legjislacionit në

fuqi. Shoqeria sipas rastit, vendos te jete si investuese dhe/ose zhvilluese e vetme ne projekt investimi ose bashkezhvilluese dhe/ose bashkeinvestuese ne bashkepunim me sektorin public dhe/ose privat, porositese e investimit, apo bashkepjesemarrrese ne investim ne çdo lloj forme tjeter te parashikuara nga legjislacioni ne fuqi.

- Me iniciative te vet dhe/apo propozim te subjektit/eve private Shoqeria mund te vendose troje ne pronesi te saj ne dispozicion te zhvilluesit privat me qellim zhvillimin e tyre. Forma e financimit te investimit te ndertimit si dhe forma e bashkepunimit percaktohet rast pas rasti. Kushtet, kriteret dhe procedura e perzgjedhjes te zhvilluesit privat behet ne baze te parimit te konkurruesmerise dhe te legjislacionit perkates qe rregullon kete fushe pervec rasteve kur sipas analizes ligjore dhe/ose studimit te fizibilitetit eshte e pamundur qe projekti te kete leverdisshmeri nese nuk pershtatet me rrethanat e situatave konkrete, qe diktojne kontraktimin direkt te nje zhvilluesi.
- Ndermjet zhvilluesit dhe shoqerise nenshkruhet marreveshja perkatese ku percaktohen te drejtat dhe detyrimet e paleve. Pasurite e perfituara nga zhvillimi/investimi regjistrohen ne emer te shoqerise dhe ajo gezon te gjitha tagrat e pronarit sipas legjislacionit ne fuqi. Shoqeria, me qellimin e vetem per te realizuar objektin e saj, mund te kryeje te gjitha operacionet ne fushen e ndertimit, industrise, tregtise, pasurive te patundshme dhe ne fushen financiare qe lidhen me objektin e shoqerise, ose qe kane lidhje me te, mund gjithashtu te kontribuojë, drejtpersedrejt ose terthorazi, por gjithmone me qellimin e vetem per arritjen e objektit te shoqerise me pjesemarrje dhe interesa ne shoqeri te tjera dhe shoqeri me objekt te njejte ose te ngjashem me te. Te shqyrtoje dhe te vleresoje mundesine e bashkepunimit me shoqeri te tjera tregtare ne te gjitha format qe parashikon legjislacioni ne fuqi.

KAPITULLI III

KAPITALI THEMELTAR DHE ORTAKËT

NENI 6

Kapitali themeltar

Kapitali fillestar i investuar nga Ortakët, përbën bazën e krijimit të fondit themeltar të mjeteve të xhiros. Administratori i dorëzon Ortakëve dokumentin vërtetues për sasitë e shumave të derdhura në fazën e themelimit.

Kapitali themeltar i shoqërisë përbëhet nga kontributi në para i Ortakut themelues. Kontributi në para do të ketë vlerën prej 100 (njëqind) lekë i ndarë në 1 (një) kuotë e zotëruar nga Ortaku i vetëm.

NENI 7

Ortaku i shoqërisë dhe kuotat e zotëruara prej tij

Ortaku i vetëm i shoqërisë tregtare “HIMARA INVEST” sh.p.k është BASHKIA HIMARË.

Ajo zotëron kuotën në shoqëri si më poshtë:

BASHKIA HIMARË, në cilësinë e Ortakut themelues zotëron 100% të vlerës së kapitalit themeltar të barabartë me një kuotë me vlerë të përgjithshme prej 100 (njëqind) lekë.

Kapitali themeltar është investuar nga ortaku themelues në total. Vlerësimi dhe pagesa e kapitalit themeltar është kryer nga Ortaku Themelues në rast të miratimit të kësaj kontrate themelimi dhe të firmosur prej tij.

NENI 8

Të drejtat dhe detyrimet e Ortakëve

Ortakët nuk mbajnë përgjegjësi për humbjet e shoqërisë përveç për pjesën e pashlyer të kontributeve të tyre që duhet të derdhen në kapitalin fillestar.

Pasuritë e krijuara nga Shoqëria gjatë aktivitetit të saj janë në pronësi të Shoqërisë. Ato (pasuritë) mund të tjetërsohen, të jepen me qera, të lihen peng e hipotekë me miratimin e Ortakëve.

Ortakët japin kontributin e tyre në shoqëri në para apo në natyrë, sipas mënyrave dhe afateve të përcaktuara në statut. Personat përgjegjës për administrimin e shoqërisë informojnë të gjithë ortakët për ecurinë e veprimtarisë së shoqërisë tregtare dhe, me kërkesën e tyre, duhet t'u vënë në dispozicion llogaritë vjetore, përfshirë llogaritë e konsoliduara, raportet për gjendjen dhe ecurinë e veprimtarisë së shoqërisë tregtare, raportet e organeve drejtuese apo të ekspertëve kontabël të autorizuar, si dhe çdo dokument tjetër të brendshëm të shoqërisë, me përjashtim të rastit të sekretit tregtar, i cili është një e dhënë e vlerësuar nga shoqëria si informacion i brendshëm apo dokument që shoqëria mbron, i cili në rast se do tu përhapej personave të paautorizuar do ti shkaktonte dëm të konsiderueshëm interesave tregtare të shoqërisë.

Ortakët kanë të drejtë të heqin dorë nga shoqëria dhe të shesin pjesën e tyre të kapitalit, në përputhje me kushtet e përcaktuara në Statut dhe në ligj.

Heqja dorë nga shoqëria nuk i liron ata nga detyrimet që ata kanë ndaj shoqërisë deri në momentin e heqjes dorë dhe nuk rrezikon marrjen e të ardhurave nga shoqëria të siguruar deri në atë moment.

Gjatë ushtrimit të të drejtave, ortakët veprojnë, duke marrë parasysh interesat e shoqërisë dhe të ortakëve të tjerë. Ata gëzojnë, të njëjtat të drejta, kanë të njëjtat detyrime e trajtohen në mënyrë barabartë. Ortakët respektojnë detyrimet që burojnë nga Akti i Themelimit dhe Statuti. Ata përpiqen për fillimin e aktivitetit të Shoqërisë sipas objektit të veprimtarisë së saj.

NENI 9

Abuzimi i ortakëve ndaj shoqërisë

Ortakët e shoqërisë tregtare, që kryejnë një apo më shumë nga veprimet ose mosveprimet vijuese përgjigjen personalisht e në mënyrë solidare për detyrimet e shoqërisë, me të gjithë pasurinë e tyre nëse:

a) abuzojnë me formën e shoqërisë tregtare për arritjen e qëllimeve të paligjshme;

- b) trajtojnë pasuritë e shoqërisë tregtare si të ishin pasuritë e tyre;
- c) në çastin kur kanë marrë apo duhet të kishin marrë dijeni për gjendjen e paaftësisë paguese të shoqërisë, nuk marrin masat e nevojshme, për të siguruar që shoqëria, në varësi të llojit të veprimtarisë së ushtruar, të ketë kapitale të mjaftueshme, për të përmbushur detyrimet e marra përsipër ndaj palëve të treta.

NENI 10

Ndalimi i konkurrencës

Ortakët nuk mund të mbajnë një pozicion drejtues apo të jenë të punësuar në shoqëri të tjera, që ushtrojnë veprimtari në të njëjtin sektor ekonomik me shoqërinë. Gjithashtu, ata nuk mund të mbajnë statusin e tregtarit për të ushtruar veprimtari në këtë sektor.

Ndalimi i përmendur më sipër mund të shfuqizohet nëpërmjet një autorizimi të posaçëm, të dhënë nga asambleja e përgjithshme me 51% të votave.

Ky autorizim mbetet në fuqi edhe pas humbjes së cilësive apo statusit të përmendur në të, por jo për një periudhë më të gjatë se një vit pas humbjes së kësaj cilësie.

Nëse ndonjëri prej ortakëve shkel ndalimin e konkurrencës, shoqëria mund:

- a) ta përjashtojë atë nga shoqëria apo ta shkarkojë nga detyra;
- b) të kërkojë ndërprerjen e veprimtarisë konkurruese;
- c) të ngrejë padi për shpërblimin e dëmit.

Shoqëria, si alternativë të ngritjes së padisë për shpërblimin e dëmit, mund t'i kërkojë secilit prej ortakëve:

- a) të pranojë që transaksionet e kryera për llogari të tij të kalohen për llogari të shoqërisë;
- b) t'i transferojë shoqërisë të gjitha përfitimet që ka marrë nga kryerja e veprimeve për llogari të personave të tretë;
- c) t'i transferojë shoqërisë të gjitha të drejtat e kreditë, që kanë rrjedhur nga kryerja e veprimeve për llogari të personave të tretë.

NENI 11

Largimi i ortakut nga shoqëria dhe likuidimi i kuotës

Ortaku mund të largohet nga shoqëria nëse ortakët e tjerë ose shoqëria kanë kryer veprime në dëm të tij, nëse është penguar të ushtrojë të drejtat e tij, nëse shoqëria i ka ngarkuar detyrime të paarsyeshme apo për shkaqe të tjera, që e bëjnë të pamundur vazhdimin e ortakërisë.

Ortaku që kërkon largimin, duhet të njoftojë shoqërinë me shkrim, si dhe të parashtojë shkaqet e largimit.

Administratorët duhet të thërrasin mbledhjen e asamblesë së përgjithshme menjëherë pasi të kenë marrë dijeni për njoftimin e largimit, për të vendosur nëse ortakut do t'i likuidohet kuota, si pasojë e largimit për shkaqe të arsyeshme.

Ortakut ka të drejtë të ngrejë padi në gjykatë ndaj shoqërisë për likuidimin e kuotës, si pasojë e largimit për shkaqe të arsyeshme, nëse pas njoftimit të largimit asambleja e përgjithshme nuk mbledhet apo nuk i njeh si të arsyeshme shkaqet e largimit dhe likuidimin e kuotës.

Ortakut që kërkon largimin nga shoqëria, detyrohet ta dëmshpërblejë shoqërinë për dëmet e shkaktuara, nëse rezulton se largimi është kryer në bazë të shkaqeve të paarsyeshme.

Ortakut që largohet ka të drejtë të ngrejë padi ndaj shoqërisë dhe/ose ortakëve të tjerë që shkaktuan largimin e tij dhe të kërkojë ndaj tyre, në mënyrë solidare, shpërblimin e dëmit të pësuar.

NENI 12

Përfshirja e ortakut

Në bazë të një vendimi të zakonshëm, asambleja e përgjithshme mund të kërkojë gjykatës përfshirjen e ortakut, nëse ai nuk ka shlyer kontributin e tij, apo nuk ka paguar kontributin si pasojë e një financimi, investimi, shtimi në kapital dhe detyrime të tjera të parashikuara në Statut apo nëse ekzistojnë shkaqe të arsyeshme për përfshirjen e tij sipas parashikimeve të statutit ose nëse ekzistojnë shkaqe të tjera të arsyeshme për këtë përfshirje.

Konsiderohen shkaqe të arsyeshme për përfshirjen e ortakut, por pa u kufizuar në to, rastet kur ortakut:

- me dashje apo me pakujdesi të rëndë i shkakton dëme shoqërisë ose ortakëve të tjerë;
- me dashje apo me pakujdesi të rëndë shkel statutin ose detyrimet e përcaktuara me ligj;
- përfshihet në veprime, të cilat e bëjnë të pamundur vazhdimin e marrëdhënieve midis shoqërisë tregtare dhe ortakut
- me veprimet e tij dëmton ose pengon ndjeshëm veprimtarinë tregtare të shoqërisë.

Gjatë procedurës së përfshirjes së ortakut, me kërkesë të paditësit, gjykata mund të marrë një masë për sigurimin e padisë, duke pezulluar të drejtën e votës së ortakut, që kërkohej të përfshihet, si dhe të drejtat e tjera, që rrjedhin nga zotërimi i kuotës së shoqërisë, kur ajo vlerëson këtë masë si të nevojshme dhe të justifikuar.

Shoqëria ka të drejtë t'i kërkojë ortakut të përfshiruar shpërblimin e dëmit të pësuar nga veprimet, që kanë sjellë përfshirjen.

Ortakut ka të drejtë t'i kërkojë shoqërisë shpërblimin e dëmit të pësuar, nëse kërkesa për përfshirje nuk është e bazuar.

Ortakut nuk ka të drejtë t'i kërkojë shoqërisë likuidimin e kuotës, nëse ai përfshihet për shkaqe arsyeshme, por, nëse shoqëria ngre ndaj tij padi për shpërblim dëmi, ortakut ka të drejtë të kompensojë çdo shumë, që do të kishte të drejtë ta përfitonte në cilësinë e likuidimit të kuotës, me dëmin e kërkuar nga shoqëria.

NENI 13**Zmadhimi dhe zvogëlimi i kapitalit**

Kapitali themeltar mund të zmadhohet ose të zvogëlohet nga Asambleja e Përgjithshme në përputhje me legjislacionin tregtar Shqiptar.

Zmadhimi i kapitalit mund të vendoset kur e kërkojnë interesat e Shoqërisë duke vendosur kuotat suplementare të Ortakëve.

Zmadhimi i kapitalit mund të realizohet me anë të kontributeve në para, me anë të kontributeve në natyrë ose me përfshirjen e rezervave dhe fitimit.

Zmadhimi i kapitalit mund të realizohet nëpërmjet emitimit të kuotave të reja, apo nëpërmjet rritjes së vlerës së tyre. Kuotat duhet të jenë të nënshkruara dhe vlera e tyre do të jetë e shlyer plotësisht.

Zvogëlimi i kapitalit nuk duhet të dëmtojë kreditorët e as të krijojë pasiguri tek ata që kanë dhënë kredi para publikimit të zvogëlimit të kapitalit. Në të kundërtën Gjykata e konsideron pavlefshëm këtë vendim mbi kërkesën e kreditorëve.

NENI 14.**Pronësia mbi kuotat dhe transferimi i tyre**

Kuotat e kapitalit dhe të drejtat që rrjedhin prej tyre fitohen ose kalohen, nëpërmjet:

- kontributit në kapitalin e shoqërisë;
- shit-blerjes;
- dhurimit;
- në çdo mënyrë tjetër të parashikuar në ligj.

Kuotat mund të transferohen personave të tretë vetëm me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve/Ortakut të Vetëm. Në çdo rast, ortakët e shoqërisë gëzojnë të drejtën e parablerjes. Cdo transferim duhet të bëhet në përputhje me dispozita ligjore në fuqi dhe duhet të regjistrohet pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit.

NENI 15**Anullimi i kuotave**

Kuotat mund të anulohen në çdo rast me miratimin e ortakut përkatës dhe të gjitha të drejtat dhe detyrimet që i rrjedhin ortakut nga zotërimi i kuotës, shuhet me anullimin e tyre.

Rastet e anulimit të kuotës do të përcaktohen nga rregulloret e posaçme, të miratuar nga Asambleja e Ortakëve.

Anullimi i kuotës vendoset dhe realizohet me shumicë të kualifikuar të Asamblesë së Ortakëve me 75% të votave dhe gjithmonë në rast ekzistence të shkaqeve të arsyeshme.

Ndërsa likuidimi i saj do të bëhet sipas përcaktimeve të nenit 9 të këtij statuti.

KAPITULLI IV

ORGANET E SHOQËRISË

NENI 16

Asambleja e Përgjithshme

Organi themelor i shoqërisë është Asamblea e Përgjithshme. Asamblea e Përgjithshme merr vendime të cilat kërkojnë $\frac{1}{2}$ e votave në rastet e mëposhtme:

1. ndryshimet e statutit;
2. zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
3. riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
4. shpërndarjen e fitimeve;
5. raste të tjera të parashikuara nga ligji ose statuti;

Për rastet e tjera ajo vendos me shumicën e votave të ortakëve pjesëmarrës si më poshtë:

1. miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
2. çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.
3. përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
4. emërimin e shkarkimin e administratorëve;
5. emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
6. përcaktimin e shpërblimeve për administratorët, likuiduesit dhe ekspertët kontabël të autorizuar.
7. mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
8. miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
9. pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
10. përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve.

NENI 17

Mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme

Asambleja e Përgjithshme është e detyruar dhe me çdo kusht të mbledhet sa herë që mbledhja është e nevojshme për të mbrojtur interesat e shoqërisë në rastet e mëposhtme:

- sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezulton ose ekziston rreziku që aktivet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 muajve në vazhdim.
- shoqëria propozon të shesë apo të disponojë në mënyrë tjetër aktive, të cilat kanë një vlerë më të lartë se 5 për qind të aseteve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.

- shoqëria, brenda 2 viteve të para pas regjistrimit të saj, propozon të blejë nga një ortak pasuri, që kanë vlerë më të lartë se 5 për qind të aseteve të shoqërisë, që rezultojnë në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.
- Asambleja e përgjithshme thirret nga administratorët apo ortakët të cilët përfaqësojnë të paktën 5% të totalit të votave në asamblenë e përgjithshme të shoqërisë.
- Në rastet e parashikuara në pikën një dhe tre më sipër, përpara Asamblesë së Përgjithshme paraqitet një raport i përgatitur nga një ekspert kontabël i autorizuar, i pavarur.
- Në raste të parashikuara në pikën një dhe tre Asambleja e Përgjithshme mund të miratojë rezolutë këshilluese, duke miratuar apo bërë vërejtje për veprimtarinë e administratorëve.

NENI 18

Thirrja e Asamblesë së Përgjithshme

Asambleja e përgjithshme thirret nëpërmjet një njoftimi me shkresë ose, me njoftim nëpërmjet postës elektronike. Njoftimi me shkresë apo me mesazh elektronik duhet të përmbajë vendin, datën, orën e mbledhjes dhe rendin e ditës e t'u dërgohet të gjithë ortakëve përpara datës së parashikuar për mbledhjen e asamblesë në përputhje me parashikimet ligjore.

Kur asambleja e përgjithshme nuk është thirrur si më sipër, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse të gjithë ortakët janë dakord, për të marrë vendime, pavarësisht parregullsisë

NENI 19

Kuorumi i nevojshëm dhe vendim-marrja

Në rastin e marrjes së vendimeve, që kërkojnë një shumicë të zakonshme, asambleja e përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote, që zotërojnë më shumë se 30% për qind të kuotave. Në rastin kur asambleja e përgjithshme duhet të vendosë për çështje, të cilat kërkojnë shumicë të kualifikuar, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse ortakët që zotërojnë më shumë se gjysmën e numrit total të votave janë të pranishëm personalisht, votojnë me shkresë, apo mjete elektronike.

Nëse asambleja e përgjithshme nuk mund të mbledhet për shkak të mungesës së kuorumit të përmendur më sipër, asambleja mbledhet përsëri jo më vonë se 30 ditë, me të njëjtin rend dite.

Asambleja e përgjithshme vendos me tri të katërtat e votave të ortakëve pjesëmarrës, për ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë. Për çështjet e tjera, asambleja e përgjithshme vendos me shumicën e votave të ortakëve pjesëmarrës.

Çdo kuotë jep të drejtën e një vote. Ortakët, që nuk janë të pranishëm, kanë mundësinë e pjesëmarrjes në mbledhjen e asamblesë së përgjithshme me mjete të ndryshme komunikimi, përfshirë mjetet elektronike, me kusht që të garantohet identifikimi i ortakëve.

Ortakut, që pengohet të ushtrojë të drejtat që i rrjedhin nga zotërimi i kuotës së shoqërisë, ka të drejtë t'i kërkojë gjykatës të urdhërojë ndalimin e cenimit apo shpërblimin e dëmit të shkaktuar, si pasojë e cenimit të këtyre të drejtave.

NENI 20

Procesverbali i mbledhjes së asamblesë

Të gjitha vendimet e asamblesë së përgjithshme duhet të regjistrohen në procesverbal.

Administratorët përgjigjen për ruajtjen e kopjeve të procesverbaleve të mbledhjeve të asamblesë së përgjithshme.

Procesverbali duhet të përmbajë datën e vendin e mbledhjes, rendin e ditës, emrin e kryetarit, ose të autorizuarit prej tij, e të mbajtësit të procesverbalit, rezultatet e votimit.

Procesverbalit i bashkëlidhet edhe lista e pjesëmarrësve, si edhe akti i thirrjes së asamblesë së përgjithshme.

Procesverbali i mbledhjes nënshkruhet nga kryetari, ose nga i autorizuari prej tij, dhe nga mbajtësi i procesverbalit.

NENI 21

Raportimi, monitorimi dhe kontrolli administrative

Shoqëria ushtron veprimtarinë e saj në përputhje me legjislacionin në fuqi, këtë statut, Aktin e Themelimit dhe vendimet e Asamblesë së Ortakut të vetëm.

Administratori i shoqërisë është i detyruar të sigurojë transparencë në ushtrimin e veprimtarisë dhe të paraqesë raporte periodike dhe raportin vjetor të veprimtarisë dhe gjendjes financiare pranë Asamblesë së Ortakut të vetëm, sipas afateve dhe formës së përcaktuar prej saj.

Bashkia Himarë, në cilësinë e Ortakut të vetëm, nëpërmjet strukturave të saj përkatëse, ndjek dhe monitoron veprimtarinë financiare dhe administrative të shoqërisë, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe parimet e qeverisjes së mirë. Kontrolli financiar dhe administrativ ushtrohet pa ndërhyrë në autonominë operationale të shoqërisë, duke synuar garantimin e ligjshmërisë, eficiencës, transparencës dhe mbrojtjes së interesit publik.

Shoqëria i nënshtrohet gjithashtu kontrollit dhe auditimit nga institucionet kompetente shtetërore, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi.

NENI 22

Administratori

Asambleja e përgjithshme emëron një ose më shumë persona fizikë si administratorë të shoqërisë. Afati i emërimit, nuk mund të jetë më i gjatë se 5 vjet, me të drejtë ripërtëritjeje.

Emërimi i administratorëve prodhon efekte pas regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit.

Statuti mund të caktojë rregulla të posacme për emërimin e administratorëve.

Administator i Shoqërisë do të jetë:

Z.Donjaldo Hoxha, shtetas shqiptar, lindur në Përmet, më 30/04/1991, madhor e me zotësi të plotë juridike për të vepruar, mbajtës i Kartës së Identitetit me Nr. J11230024H.

Shoqëria do të përfaqësohet përpara ç'do organi administrativ, gjyqësor, apo ç'do entiteti tjetër publik apo privat dhe në marrëdhënie me të tretët nga Administratori i shoqërisë, i cili i ushtron të drejtat e tij në përputhje me Statutin e shoqërisë dhe me legjislacionin shqiptar në fuqi.

NENI 23

Të drejtat dhe detyrimet e administratorit

Administratori ka të drejtë e detyrohet të:

1. kryejë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme;
2. përfaqësojë shoqërinë tregtare;
3. kujdeset për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
4. përgatisë dhe nënshkruajë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, të paraqesë këto dokumente përpara asamblesë së përgjithshme për miratim;
5. krijojë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
6. kryejë regjistrimet dhe dërgojë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Biznesit;
7. raportoje përpara asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;
8. kryejë detyra të tjera të përcaktuara në ligj dhe në statut.
9. Për aq sa është e lejueshme dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi, Administratori ka të drejtë të kryejë veprimtari tregtare në emër dhe për llogari të shoqërisë, pa qenë nevoja të marrë paraprakisht pëlqimin e Asamblesë së Përgjithshme, nëse:
 - a. këto veprime janë në përputhje me objektin, veprimtarinë dhe politikat e shoqërisë;
10. Asambleja e Përgjithshme mund të shkarkojë administratorin në çdo kohë me shumicë të zakonshme. Statuti apo marrëveshje të tjera nuk mund të përjashtojnë apo kufizojnë këtë të drejtë. Paditë, që lidhen me shpërblimin e administratorit, në bazë të marrëdhënieve kontraktore me shoqërinë, rregullohen sipas dispozitave ligjore në fuqi.

NENI 24

Shpërblimi i administratorëve

Shpërblimit bazë të administratorëve mund t'i bëhen shtesa, që mund të jenë përqindje në fitim ose të ngjashme. Shpërblimet e administratorëve përcaktohen me vendim të zakonshëm të asamblesë së përgjithshme.

Shpërblimi, duhet të jetë i përshtatshëm dhe në përputhje me detyrat e administratorëve dhe gjendjen financiare të shoqërisë.

Nëse shoqëria është në vështirësi financiare, asambleja e përgjithshme mund të vendosë reduktimin e shpërblimit të administratorëve në masën e përshtatshme.

Kriteret e shpërblimit, shpërblimi individual dhe efekti vjetor i shpërblimit të administratorëve në strukturën e kostove të shoqërisë tregtare publikohen së bashku me pasqyrat financiare vjetore.

KAPITULLI V

ADMINISTRIMI FINANCIAR I SHOQËRISË

NENI 25

Eksperti/ët Kontabël të Autorizuar

Shoqëria emëron ekspertin/ët kontabël të autorizuar për një afat një vjeçar në rastet parashikuara nga ligji. Emërimi i tyre bëhet nga Asambleja e Përgjithshme. Ata duhet të kryejnë funksionet audituese në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Ata janë përgjegjëse për dëmet e shkaktuara që mund të vijnë nga mbajtja e llogarive në mënyrë të parregullit.

NENI 26

Fondet rezerve

Shoqëria disponon lirisht mjetet e veta financiare për shlyerien e detyrimeve gjatë veprimtarisë së saj.

NENI 27

Përdorimi i të ardhurave neto.

E ardhura neto që rezulton mbasi zbriten shpenzimet e bëra për kryerjen e çdo lloj aktiviteti nga zbritja e vlerës së amortizimit, nga tatimet dhe taksat, nga kuotat që rritin kredinë për investime, pagat e shpërblimet, përdoret nga Ortakët, sipas qëllimeve të tyre.

NENI 28

Bilanci, plani financiar.

Pasuria e Shoqërisë vlerësohet në bilancet e saj në monedhë të vendit ose në monedhë të huaj sipas vlerësimit të Ortakëve ose ekspertëve në momentin e Themelimit të Shoqërisë. Bilanci vjetor paraqitet brenda datës 31 Mars të vitit pasardhës. Forma e bilancit përcaktohet nga Administratori në harmoni me format e bilanceve të vendosura në Republikën e Shqipërisë.

Plani financiar parashikon aktivin e pasivin e aktivitetit ekonomik të Shoqërisë, të shprehur në lekë ose valutë të konvertueshme. Llogaria ekonomike do të mbahet në Shqipëri. Shkëmbimi i monedhës shqiptare me atë të huaj dhe anasjelltas bëhet sipas kursit zyrtar ose privat të këmbimit.

NENI 29

Shpërndarja e fitimeve

Ortakët kanë të drejtë të ndajnë pjesën e fitimit të deklaruar në pasqyrat financiare të shoqërisë. Fitimi u shpërndahet ortakëve në raport me kuotat e zotëruara.

NENI 30

Kufizimi i shpërndarjeve të fitimeve

Shoqëria mund t'u shpërndajë fitime ortakëve, vetëm nëse pas pagimit të dividendit:

- a. aktivet e shoqërisë mbulojnë tërësisht detyrimet e saj;
- b. shoqëria ka aktive likuide të mjaftueshme për të shlyer detyrimet që bëhen të kërkueshme brenda 12 muajve në vazhdim.

Administratorët lëshojnë një certifikatë të aftësisë paguese, e cila konfirmon shprehimisht se shpërndarja e propozuar e dividendëve përmbush kërkesat e mësipërme. Kjo certifikatë e aftësisë paguese duhet të konfirmohet edhe nga eksperti kontabël i autorizuar.

Kur gjendja e shoqërisë tregon se shpërndarja e propozuar e dividendëve nuk i përmbush këto kritere, administratorët nuk mund ta lëshojnë këtë certifikatë.

KAPITULLI VI

MARRDHËNIET E PUNËS.

NENI 31

Marrëdhëniet e punës në Shoqëri rregullohen sipas dispozitave të Aktit të Themelimit, Statutit dhe Legjislacionit Shqiptar të Kodit të Punës.

Punësimi në Shoqëri realizohet me anë të kontrates individuale të punës midis Shoqërisë dhe të punësuarve. Marrëdhëniet midis Shoqërisë e sindikatës rregullohen nëpërmjet kontratës kolektive të punës.

NENI 32

Të punësuarit dhe punonjësit drejtues administrativ të Shoqërisë ushtrojnë veprimtarinë e tyre me profesionalizëm, integritet dhe përgjegjësi, duke respektuar legjislacionin në fuqi, aktet e brendshme të shoqërisë, përshkrimet e punës dhe standardet e mira të administrimit.

Ata ushtrojnë detyrat e tyre me kujdesin e nevojshëm profesional, në funksion të interesit të Shoqërisë dhe interesit publik, në përputhje me parimet e transparencës, ligjshmërisë dhe eficiencës.

KAPITULLI VI

MODIFIKIMI I FORMËS LIGJORE, PRISHJA E SHOQËRISË, LIKUJDIMI

NENI 33

Modifikimi i formës ligjore

Forma ligjore e shoqërisë mund të ndryshohet me vendim të Asamblesë së Përgjithshme në përputhje me parashikimet legjislativë në fuqi.

Shoqëria e re do të përmbushë të gjitha procedurat ligjore të regjistrimit në Shqipëri.

NENI 34

Prishja e shoqërisë

Kjo Shoqëri do të priset në rastet kur:

1. merr vendim Asambleja e Përgjithshme;
2. hapen procedurat e falimentimit;
3. nuk ka kryer veprimtari tregtare për dy vjet dhe nuk është njoftuar pezullimi i veprimtarisë në përputhje me pikën 3 të nenit 43 të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit";
4. merret një vendim gjykatë;
5. për arsye të tjera, të parashikuara në statut;

Prishja e shoqërisë regjistrohet në Regjistrin Tregtar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit nga Administratorët.

NENI 35

Likuidimi i shoqërisë

Prishja e shoqërive tregtare ka si pasojë hapjen e procedurave të likuidimit në gjendjen e aftësisë paguese, me përjashtim të rasteve kur është nisur një procedurë falimentimi.

Likuidimi kryhet nga likuiduesit e emëruar nga asambleja e përgjithshme. Nëse asambleja e përgjithshme nuk merr një vendim për emërimin e likuiduesve, brenda 30 ditëve pas prishjes, çdo person i interesuar mund t'i drejtohet gjykatës, për të caktuar një likuidues.

Çdo person i interesuar, ka të drejtë t'i kërkojë gjykatës zëvendësimin e likuiduesit, sipas vendimit të ortakëve, nëse paraqet arsye të mjaftueshme për të dyshuar se likuidimi i rregullt i shoqërisë mund të cenohet nga likuiduesit e emëruar si më sipër. Kërkesa duhet të depozitohet në gjykatë brenda 30 ditëve nga data e caktimit të likuiduesit.

Gjykata emëron likuiduesin, në rastet kur shoqëria tregtare priset me vendim gjykatë.

Likuiduesit shkarkohen dhe zëvendësohen me të njëjtat kushte, të parashikuara në dispozitat për emërimin e tyre.

Administratorët e shoqërisë i njoftojnë për regjistrim, Qendrës Kombëtare të Biznesit të dhënat e likuiduesve të parë dhe tagrat e tyre, për të përfaqësuar shoqërinë, së bashku me dokumentet përkatëse. Likuiduesit depozitojnë nënshkrimin e tyre. Likuiduesit i njoftojnë, gjithashtu, Qendrës Kombëtare të Biznesit për regjistrim çdo ndryshim për identitetin dhe tagrat e tyre të përfaqësimit. Emërimi i likuiduesve nga gjykata regjistrohet ex officio, sipas nenit 45 të ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit".

Me hapjen e procedurave të likuidimit, emri i regjistruar i shoqërisë ndiqet nga shënimi "në likuidim". Likuiduesit duhet të ftojnë kreditorët e shoqërisë për të depozituar pretendimet e tyre për prishjen e saj brenda 30 ditëve. Likuiduesi merr përsipër të drejtat dhe detyrimet e administratorëve nga data e emërimit të tij.

NENI 36

Të drejtat e detyrimet e likuiduesit

Detyra e likuiduesve është mbyllja e të gjitha veprimeve të shoqërisë, mbledhja e kredive të paarkëtuara dhe e kontributeve të pashlyera, shitja e pasurive të shoqërisë dhe shlyerja e kreditorëve duke respektuar radhën e referimit, sipas nenit 605 të Kodit Civil.

Likuiduesi mund të kryejë edhe veprime të reja tregtare, për mbylljen e një veprimi të papërfunduar. Nëse, në bazë të padive të ngritura nga kreditorët, likuiduesit vërejnë se pasuria e shoqërisë tregtare, përfshirë kontributet e pashlyera, nuk është e mjaftueshme për pagesën e këtyre pretendimeve, likuiduesit detyrohen ta pezullojnë procedurën e likuidimit e t'i kërkojnë gjykatës përkatëse nisjen e procedurave të falimentimit.

NENI 37

Bilancet

Likuiduesi përgatit një bilanc të gjendjes së shoqërisë në çastin e hapjes së likuidimit dhe një bilanc përfundimtar në çastin e mbylljes së këtyre procedurave. Nëse procedura e likuidimit zgjat më shumë se një vit, likuiduesi përgatit, gjithashtu, pasqyrat financiare vjetore të shoqërisë.

Bilancet miratohen nga Asambleja e Përgjithshme.

NENI 38

Shpërndarja e aktiveve

Pas shlyerjes së detyrimeve ndaj kreditorëve, likuiduesi u shpërndan ortakëve aktivet e mbetura, sipas të drejtave që ata kanë në ndarjen e fitimeve, me përjashtim të rastit kur statuti parashikon radhë preference. Pasuritë, që i janë dhënë shoqërisë me qira apo në përdorim, me çfarëdo tituli u kthehen ortakëve apo aksionerëve. Pas shpërndarjes së aktiveve të mbetura, likuiduesi e njofton Qendrën Kombëtare të Biznesit për përfundimin e likuidimit dhe kërkon çregjistrimin e shoqërisë.

NENI 39

Likuidimi i thjeshtëzuar

Shoqëria mund të likuidohet nëpërmjet një procedurë të përsheptuar, nëse kjo vendoset nga të gjithë ortakët dhe kur këta deklarojnë përpara gjykatës përkatëse se të gjitha detyrimet e shoqërisë ndaj kreditorëve janë shlyer e janë rregulluar të gjitha marrëdhëniet me punëmarrësit.

Administratorët, në përputhje me nenin 43 të ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit", njoftojnë për regjistrim pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit vendimin për likuidimin e shoqërisë, nëpërmjet procedurës së thjeshtëzuar.

Administratorët ushtrojnë detyrat e tyre gjatë procesit të likuidimit të thjeshtëzuar me profesionalizëm, kujdes dhe përgjegjësi, në përputhje me legjislacionin në fuqi, aktet themeluese dhe vendimet e Asamblesë së Ortakëve. Veprimet dhe vendimmarrja gjatë këtij procesi synojnë mbrojtjen e interesave të shoqërisë, respektimin e të drejtave të palëve të treta dhe garantimin e ligjshmërisë dhe transparencës.

KAPITULLI VII.

DISPOZITA TË FUNDIT.

NENI 40

Ky Statut hyn në fuqi pas miratimit dhe regjistrimit të Shoqërisë në regjistrin tregtar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit.

NENI 41

Gjithçka nuk është parashikuar shprehimisht në këtë Statut do të disiplinohet nga legjislacioni tregtar dhe ligje të tjera të lidhura me të në fuqi në Republikën e Shqipërisë.

NENI 42

Ky Statut përpilohet në 4 kopie të njejta në gjuhën shqipe e nënshruhet pa vërejtje nga ortaku themelues.

ORTAKU THEMELUES

BASHKIA HIMARË

KRYETARI

Vangjel Tavo

